



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIC - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.21.02.2024, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Drejtorët komunal, Fatime Pllana, udhëheqëse e sektorit për Arsim, Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2023
4. Shqyrtimi i kërkesës nga DKA-ja, për shqyrtim të Projekt Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së për Draft Statutin e Bibliotekës Komonale të Qytetit
6. Shqyrtimi i kërkesës nga DAP-ja, për Raportin e Performancës të Komunës së Obiliqit për vitin 2022
7. Shqyrtimi i kërkesës së DMM-së, për shfuqizimin e vendimit nr.-I-94, të dt.07.06.2019
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ne e kemi marrë vetëm kërkesën për raportin e punës së Kryetarit, por presim sot që të na dëgjojnë materialin që pastaj ta keni edhe ju për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ky raport të shkoj në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Ashtu, siç e cekët edhe ju kam pasë vërejtje sepse na ka ardhë vetëm kërkesa, e jo raporti dhe jo me kusht, por me lutjen që të na vjen raporti paraprakisht në mënyrë që nëse, kemi pyetje ti shqyrtojmë gjatë seancës, ne jemi pro që kjo pikë të shkoj për shqyrtim në seancën e Kuvendit Komunal.

Kryesuesja - Unë sot do të kontaktoj edhe një herë edhe pse nuk e kam obligative me shefin e kabinetit të Kryetarit sepse ai ka thënë qysh të premten ose dje se të hënën ishte festë se do ta sjellë Raportin e punës së Kryetarit, por ende nuk e ka sjellë. Nëse, ky material nuk bashkamgjitet atëherë do të hiqet nga rendi i ditës. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin e punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për vitin 2023.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DKA-ja, për shqyrtimin e Projekt Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimsdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe atje do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti - Unë e kam një pyetje zakonisht Projekt Rregulloret fillimisht vijnë në Kuvend, e marrin dritën jeshile për të vazhdue në debatet publike dhe me krejtë materialet paraprake të të gjitha seancave. Mund të jem në gabim, por nuk kam hasë dikund që kjo pikë e rendit të ditës ka ardhë ndonjëherë në Kuvend te ne për të kërkuar që të vazhdoj më tutje. Përndryshe, çdo gjë çka i sjellë të mira Arsimit kryesisht si pika kyqe që është për të tashmen dhe të ardhmen ne jemi pro dhe shpresoj se kemi me u mundue me dhënë kontributin maksimal. Unë nuk pashë dikund që paraprakisht e kemi pasë në ndonjëherë prej seancave këtë pikë të rendit të ditës.

Kryesuesja - Nëse, nuk gaboj në tetor apo nëntor ka qenë kërkesë për debat publik, është kërkuar kohë më shumë për shkak të këtyre ndryshimeve që janë bë pas debatit publik, është kontaktuar edhe Ministria, që e kemi diskutue paraprakisht me qenë gjithçka në rregullë para se të vijë në Kuvend për aprovim. Pra, kjo Projekt Rregullore ka marrë lejen në Kuvend për debat publik.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DKA-ja, për shqyrtimin e Projekt Rregullores për organizimin e punës në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, udhëheqësit, mësimsdhënësit, nëpunësit profesional, mbështetës, nxënësit dhe masat disiplinore.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DKRS-së, për Draft Statutin e Bibliotekës Komonale të Qytetit.

Enver Gashi – Edhe kjo kërkesë mund të shkoj në seancën e Kuvendit, pasi që veç ka qenë në debat publik. Neve, na kujtohet që ka qenë në Kuvend dhe Kuvendi ia ka dhënë vizën për debat publik sikurse edhe kërkesa paraprake dhe në Kuvend sigurisht se nëse, kemi diçka do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në seancën e ardhshme në Kuvendin Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimi e kërkesës së DKRS-së, për Draft Statutin e Bibliotekës Komonale të Qytetit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DAP-ja, për Raportin e Performancës të Komunës së Obiliqit për vitin 2022.

Enver Gashi – Është një raport i mirë dhe një performancë që jemi në nivel vendi të dytët dhe është mirë që sa më shpesh për suksese të tilla të diskutojmë dhe njoftohemi në Kuvend. Ne jemi për atë që raporti i performancës të shkoj në Kuvendin Komunal.

Sami Ahmeti – Çdo raport që vjen në Kuvend respektivisht që delë para qytetarëve e mirëpresim. Krejtë çka kërkojmë edhe për pikat paraprake dhe për pikat vijuese kur bëhet fjalë për raporte, Rregullore apo gjëra të ndryshme që ndërlihen me Ministrinë në seancë të jenë përfaqësuesit e Drejtorive dhe atë jo përfaqësuesit shërbyes civil, por të jenë përfaqësuesit politik sepse Kuvendi është përfaqësim politik i qytetarëve, në mënyrë që nëse, ka pyetje, ka vërejtje le të përgjegjen ata që janë të thirrur me raportue. Ne jemi pro që kjo

pikë e rendit të ditës të shkoj në seancë dhe e mirëpresim çdo rezultat dhe çdo gjë që bëhet në të mirën e qytetarëve.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës nga DAP-ja, për Raportin e Performancës të Komunës së Obiliqit për vitin 2022.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës së DMM-së, për shfuqizimin e vendimit nr.-I-94, të dt.07.06.2019.

Enver Gashi – Ne jemi për që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe atje, do të provojmë të japim kontributin tonë nëse, veç kemi çka me dhënë sepse në fakt këto janë vendime të prera edhe të Qeverisë edhe vendime faktike në vendin ku punohet. Është me rëndësi përsëri në këto pikat e rendit të ditës që vijnë prej Drejtorive, le të dalin dhe të na i prezentojnë drejtorët në mënyrë që nëse kemi ndonjë pyetje ti shpjegojnë. Ne jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në seancë të Kuvendit Komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DMM-së, për shfuqizimin e vendimit nr.-I-94, të dt.07.06.2019.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Zyra për barazi gjinore nga zyrtarja Ganimete Aliu, për ofrim të mbështetjes për hapjen e Këndit të Kurajos brenda hapësirës së objektit të Komunës për gratë e mbijetuara të dhunës seksuale nëpërmjet punimeve artizanale në shumën prej 800 euro. Unë propozoj që kjo kërkesë të shkoj në DEFZH, për trajtim pastaj në Kuvend të na jepë sqarime se a mundet Kuvendi të marrë një vendim të tillë e nëse, po prej cilës vijë buxhetore merren mjetet në mënyrë që mos të bëjmë shkelje të panevojshme.

Enver Gashi – Jo vetëm kjo kërkesë, por të gjitha kërkesat ne jemi dakordue në fillim se duhet të shkojnë në Drejtoritë e caktuara, e me propozim të Drejtorive të vijnë në Kuvend dhe Kuvendi pastaj vendos.

Kryesuesja – Sqaron se kërkesat që protokolohen për Kuvend, arkiva ose zyra pritëse e ka obligim që atë kërkesë me ia sjellë Kuvendit sepse ka shumë njerëz që dojnë me iu adresue vetëm Kuvendit dhe nuk kemi të drejtë të ia mohojmë askujt, por që Komiteti e trajton.

Enver Gashi – Zyrtari i zyes pritëse duhet me ua sqarue se kërkesat nuk shkojnë drejtë në Kuvend, por shkojnë në Drejtori ndërsa Drejtorja i kthen, e jo një herë me kërkesat të merret Kuvendi sepse po na përsëritet në çdo mbledhje kjo çështje, nuk është e sotit.

Sami Ahmeti - Për dallim prej parafolësit unë kam nerva 2 ditë rend me i lexue kërkesat pa asnjë problem. Është e vërtetë, që jemi marrë vesh kështu, por kur na drejtohet një kërkesë qytetarët nuk e dijnë sistemin qysh funksionon, kush i ka përgjegjësitë. Kuvendi është më tepër përfaqësues se sa ekzekutues dhe për neve nuk është problem pse kërkesat vijnë në seancë. Unë pajtohem plotësisht me atë që u tha se Drejtoritë duhet me ardhë sepse edhe në fjalët paraprake që i pata qëllimi është që drejtorët me u bë më përgjegjës, jo me lënë punë periferike me i krye personat periferik këtu këto. Pa dashtë me dalë prej teme, këtë kërkesë e kam lexue edhe mbrëmë dhe më ka tingëllue shumë mirë. Ashtu siç e dini unë tashmë jam në njërën prej Ministrive, që shpesh takojmë persona njejtë sikurse që e thatë ju, kështu dje për shembull kemi pasë takim me ministren e punëve të brendshme të Bullgarisë dhe pikërisht këto dhurata prej nënave, ose prej grave të veja që kanë mbetë ishin dhuratat që iu pëlqyen tepër dhe unë jam shumë dakord jo 800 euro, por nëse kushton edhe 8,000 euro, këtë ne si Kuvend me mbështetë. Pajtohem përsëri se Drejtorja e financave duhet me ardhë me një vlerësim se cilat janë linjat buxhetore që e mbulojnë këtë fushë, por që a është mirë me u bë është shumë mirë, kështu që sido që të vendoset është mirë deri në mbajtjen e seancës Ekzekutivi, ose Drejtorja përkatëse të delë me rekomandime që kjo kërkesë të shkoj në Kuvend ose të diskutohet në Kuvend, që nëse ka bazë ne jemi të parët që jemi pro kësaj.

Kryesuesja – Unë kërkoj falje ndoshta, po dalë pak prej temës por ka të bëjë me këtë kërkesë, unë shumë kisha dashur që sot në takimin që e kishim në projektin në shkollën “Pandeli Sotiri” ku ishte prezente edhe ambasadorja e Kanadasë, të kisha një brosh të tillë apo një varëse të ia dhuroja dhe në pika të shkurtëra të ia shpjegoja historinë e këtyre grave. Me siguri se sikur ajo të kishte gjysmë ore kohë kishte me shkue me i

vizitue atje dhe i kishte pa për së afërmi. Mendoj se kjo është diçka shumë e mirë nëse, bëhet në Komunën tonë sepse vazhdimisht do e kemi para syve dhe nuk lejon me harrue fatin e këtyre grave.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan DEFZH-së, kërkesën nga Zyra për barazi gjinore për ofrim të mbështetjes për hapjen e Këndit të Kurajos brenda hapësirës së objektit të Komunës për gra e e mbijetuara të dhunës seksuale nëpërmjet punimeve artizanale në shumën prej 800 euro.

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Fatmir Kadriu, nga banorët e fshatit Baimoc për blerjen e tepihut për xhami në shumën prej 3.000 euro. Propozoj që kjo kërkesë ti rekomandohet DSHPE-së dhe DEFZH-së, për trajtim, të shohin rrugën si mundën me realizue kërkesën në fjalë.

Enver Gashi – Së pari Drejtoria përkatëse le ta shqyrton kërkesën pastaj e shohim mundësinë e realizimit.

Sami Ahmeti – Këtu, është edhe një peticion dikund rreth 31 persona dhe unë veç çka nuk pajtohem është se e ka caktue zotëriu çmimin sepse nëse i bjen 3.000 euro, mesatarja e këtyre tepihave m² është 5 euro dhe po i bjen që ajo xhami i ka 600 m² i ka ajo xhami që unë nuk besoj sepse xhamia është shumë më e vogël. Unë pajtohem plotësisht për me bë atë çmim simbolik dhe nëse, është e mundshme kishte me qenë mirë Drejtoria me na ardhë në seancë me një rekomandim sepse mund të përdoret ndonjë linjë e subvencioneve, apo diçka tjetër pa procedura të rregullta dhe pse të mos iu ndihmohet, është një kërkesë bazike. Mirëpo, prapë se prapë pa bërë asnjë shkelje dhe pa pasë nevojë me pasë ndonjë pasojë qoftë buxhetore, apo ligjore. Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan DSHPE-së, dhe DEFZH-së, kërkesën nr.-I-5177/24, e dt.20.02.2024 nga Fatmir Kadriu për blerjen e tepihut për xhami në shumën prej 3.000 euro.

Kryesuesja – Pas mbledhjes zakonisht unë dhe bashkëpunëtorja do ti adresojmë kërkesat në Drejtoritë përkaëse dhe do të kërkojmë nga ata që të jenë prezentë në seancën e Kuvendit Komunal.

E kemi kërkesën nga Naim Krasniqi përfaqësues i lagjes “Abazaj” në fshatin Breznicë për ndërrim të emrit të rrugës nga “Ram Imeri” në “Bahtir Abazi”. Ne veç kemi një përvojë nga viti i kaluar ku 3 vendime për emërtimin e rrugëve janë kthyer për shfuqizim. Është një rregullë që Drejtoria me Ministrinë përkatëse emërton rrugët nga lista pritëse dhe unë e di se këta kanë pasë diskutim publik për listën e pritjes sepse Kuvendi nuk mund të bëjë asgjë në këtë drejtim.

Sami Ahmeti – Të njëjtat vlejné ato çka i thatë ju pajtohem plotësisht sepse edhe kërkesat e tilla pa dashtë me injorue asnjë person pa asnjë peticion secili prej neve, këshut unë mundem me kërkue tash si anëtar i Kuvendit me ia hapë derën kësaj salle dikah tjetër dhe delë tjetri thotë jo në anën tjetër, e tjetri në anën tjetër. Pra, zakonisht këto kërkesa nuk mundën me u marrë parasysht në rast se nuk ka peticion ose nuk e ka pëlqimin e shumicës së qytetarëve. Mirëpo, prapë se prapë kemi përvoja të mëhershme siç e thatë edhe ju nuk ka nevojë me bë ndonjë gabim që me u kthye vendimi prapësht, le të respektohen procedurat qysh është e përpaparë dhe gjithçka është në rregullë. Do të thotë le të shkoj në Drejtori dhe ata e dinë më së miri qysh shkojnë këto punë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan DPUKP-së, kërkesa nr.-I-5093/24, e dt.16.02.2024, nga Naim Krasniqi, përfaqësues i lagjes “Abazaj” në fshatin Breznicë për ndërrim të emrit të rrugës nga “Ram Imeri” në “Bahtir Abazi”.

Pika 9 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Është folë shumë për kërkesa, për ndihma dhe kërkesa të ndryshme çka janë shumë herë të arsyeshme dhe të pranueshme. Unë e kam një kërkesë për të cilën jam shumë i sigurtë se edhe Kryetari i Komunës është i informuar prej hoxhës së Milloshevës. Në Milloshevë, që është zona e dytë me numrin më të madh të banorëve, dalëngadalë po mbaron vendi ku varrosen qytetarët dhe komplet komuniteti ka një kërkesë që me i pa mundësitë se cilat janë linjat buxhetore që ne si Komunë ta ndihmojmë për caktimin dhe shpronësimin e një parcele, e cila do të shërbente për këtë çështje që është shumë bazike dhe nuk do të duhej të ishte problem. Kryetari sigurisht që është i informuar sepse unë jam takuar me hoxhën pasi që është takuar me Kryetarin dhe ka qenë mirë që kjo temë të bisedohet edhe nëse, nuk është si pikë e rendit të ditës pa asnjë

orinetim partiak sepse është problem jam i sigurtë edhe nëpër fshatra dhe zonat tjera, por këtë zgjidhje duhet me pa sa është e mundshme me u bë. Komuniteti në Milloshevë me sa jam i informuar është i gatshëm të participoj, por Drejtoritë përkatëse bashkë me Kuvendin çka munden me bë është mirë që të diskutohet në seancën e ardhshme. Kërkesa e dytë është me mirëkuptim kërkoj që drejtori i Arsimit të jetë në seancë për shkak të vërejtjeve dhe disa punësimeve nepotike që në kohën e fundit janë bërë. Unë nuk kam informata të sakta, por këto informata i kam marrë në njërin prej institucioneve të Republikës së Kosovës, që më ka kërkuar a e njehë këtë person, a është i drejtorit, a është ky, a është ky. Unë pa dashtë me bë njolla me pasë një diskutim normal, kërkoj që drejtori i Arsimit të jetë në seancë pastaj, të ballafaqohet me disa pyetje që ne si kuvendarë i kemi.

Kryesuesja – Ne patjetër do ti adresojmë kërkesat tuaja te Kryetari që ishte për çështje të varrezave dhe kërkesën tjetër te Drejtoria përkatëse.


Labinot Mirena – Unë e kam një propozim që aksionarët në NPL “Kastrioti” me qenë me pagesë ashtu qysh janë aksionarët tjerë në Ndërmarrjet Publike Lokale tjera, sepse vetëm këta tonët janë duke u angazhuar por nuk kanë pagesë. Ndërsa, në Komunitat tjera aksionarët në Ndërmarrjet e tyre Publike Lokale janë me pagesë do të thotë dua me ngritë këtë çështje për seancën e ardhshme.

Kryesuesja – Do ta shikojmë mundësinë dhe ai propozimvendim do të jetë i gatshëm për mbledhjet që i mbajnë, jo si paga të rregullta.

Bajram Hashani – Ne e mbështesim kërkesën e z.Labinot Mirena.

Mbledhja përfundoi në ora 11:44’

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

